

**Hapet thirrja për aplikim për bursa në programin Mevlana Exchange, për studentët dhe stafin akademik për mësimdhënie, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020, në Universitetin Karamanoğlu Mehmetbey.**

Studentët e nivelit bachelor/ master dhe stafi akademik nga Universiteti i Tiranës kanë mundësinë të aplikojnë në Universitetin Karamanoğlu Mehmetbey në Turqi për bursa shkëmbimi.

<http://kmu.edu.tr/mevlana>

**Kushtet e aplikimit për studentët:**

- **Studentët që aplikojnë për periudhë shkëmbimi në Universitetin Karamanoğlu Mehmetbey:**
  - Të jenë të regjistruar në Universitetin e Tiranës në programin bachelor/master.
  - Të kenë një mesatare (GMA) së paku 2,5 në një shkallë me katër pikë.
  - Studentët duhet të kenë një certifikatë të gjuhës turke ose angleze në varësi të programit të tyre të studimit.

**Fushat e shkëmbimit:**

- Filozofi;
- Inxhinieri Kompjuterike;
- Gjuhë Turke dhe Literaturë;
- Matematikë;
- Ekonomiks;
- Administrim Biznesi;
- Sociologji;
- Histori;
- Kimi ushqimore;
- Fizikë;
- Biologji;
- Gjuhë e Huaj;
- Mësimdhënie.

**Kohëzgjatja:**

- Studentë (5 muaj);
- Staf akademik për mësimdhënie (1 deri në 3 javë).

**Dokumentacioni për aplikim për studentët:**

- Candidate Student Application Form:

[http://www.unitir.edu.al/images/Candidate\\_student\\_application\\_form.docx](http://www.unitir.edu.al/images/Candidate_student_application_form.docx) ;

- Listë Notash;

- Certifikata e Gjuhës.

### **Kompensimi financiar për studentët dhe stafin:**

- Bursa për studentët është 1200 TL (Turkish Lira) për çdo muaj. Studentët e paguajnë pagesën e shkollimit në universitetin e vendit të tyre, pra ku ata janë regjistruar dhe nuk paguajnë asnjë pagesë tjetër shkollimi në universitetin pritës.
- Kostot e udhëtimit dhe akomodimit për studentët mbulohen nga vetë aplikantët.
- Bursa për stafin akademik është 40-50TL në ditë (në varësi të titullit akademik);
- Kostot e udhëtimit për stafin janë deri në 3000TL. (akomodimi mbulohet nga vetë aplikanti)

### **Dokumentacioni për aplikim për stafin akademik:**

- Application Form, të cilin mund ta shkarkoni në adresën:  
[http://www.unitir.edu.al/images/Incoming\\_Academic\\_Staff\\_Candidate\\_Application\\_Form.doc](http://www.unitir.edu.al/images/Incoming_Academic_Staff_Candidate_Application_Form.doc)
- Cv + lista e publikimeve, sipas linkut:  
[http://www.unitir.edu.al/images/CV\\_for\\_academic\\_staff.doc](http://www.unitir.edu.al/images/CV_for_academic_staff.doc)
- Vërtetim punësimi në gjuhën shqipe;

**Afati i aplikimit:** 04 Mars 2019

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë në Rektoratin e Universitetit të Tiranës si edhe të skanuara përmes adresës [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!